[*Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim me te ulet*]

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;

4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikujt të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					

TVSH (%)	
Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkëlqje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

LOTI I I-RË :“BLERJE USHQIME ME ORIGJINE JO SHTAZORE

Lloji i mallit : **Bukë gruri**

Specifikimet teknike : të plotësojnë kërkesat e standartit shtetëror Nr 1411, te vitit 1987.

Çmimi për bukën do të jetë çmimi për një kilogram.

Pesha e bukës **900 gram**. Lejohen mënjanimet + - 3 % për çdo bukë.

Buka e grurit do të prodhohet me miell që të jetë i fresket, me ngjyrë, erë, shije dhe lagështirë konform standarteve përkatëse. Mielli nuk duhet të ketë asnjë lloj lënde të huaj.

Buka duhet të ketë formë të drejtë dhe normale, pa deformime dhe sipërfaqja e bukës duhet të jetë e lëmuar dhe pa plasje të ndryshme. Vëllimi i bukës duhet të jetë i mjaftueshem. Shija, era, lagështira dhe aciditeti i bukës duhet të jetë konform standartit teknik të prodhimit të saj.

Korja e bukës duhet të jetë e lëmuar, pa djegie, pa shkëputje të saj nga tuli, ngjyra e njëllotë, mjalti në të kuqërremte në të gjithë sipërfaqen.

Tuli duhet të jetë i pjekur mirë, me porozitet të imët në të gjithë vëllimin e tij dhe nuk duhet të ketë gjurmë mielli të pabrumosura.

Nuk pranohet bukë e shtypur, e deformuar, e papjekur, e djegur, me erë të huaj, me shije të hidhur e të thartë, me lendë të huaja, me lageshtirë jo normale, me shije myku.

Buka preferohet në formë katërkëndëshe.

Treguesit fiziko-kimikë:

Lagështira, poroziteti, aciditeti, kripa, të jenë sipas STASH 1411-87.

Buka të jetë e prodhuar brenda ditës. Furnizimi i bukës do të bëhet jo më pak se 4 orë pas pjekjes.

Ambalazhi i transportimit të bukës duhet të jetë i pastër dhe të sigurojë mos dëmtimin e saj. **Ambalazhimi i bukës të bëhet sipas Udhëzimit Nr.15 datë 13.12.2012 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit “Për materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimin”.**

Mjetet transportuese duhet të jenë të pastra, të mbyllura që të sigurohet transportim normal i bukës deri në destinacionin përkatës.

Bashkia Kruje ka të drejtë të kërkojë shoqërimin e bukës me çertifikatë cilësie ose raportin e provës, sa herë që e shikon të nevojshme.

Subjekti nëse shpallet fitues do të duhet të ketë në stafin e vet numrin e kërkuar të punonjësve në kriteret kualifikative, pergjate gjithë kohës së zbatimit të kontratës.

❖ Lloji i mallit: Bulmet dhe veze.

1. Djathë i bardhë

Kërkohet cilësia e parë, vendi, me bazë prodhim djathin/produkt i qumështit të lopës, deles, ose dhisë sipas STASH 1410-87.

Nuk lejohet prodhim i djathit me përzierje qumësht pluhur ose të kondensuar.

Djathi të ketë kaluar periudhën e stazhionimit sipas standarteve shtetërore.

Ngjyra të jetë sipas llojit të qumështit, djathë lope, i deles dhe dhisë të ketë ngjyrën karakteristike të qumështit. (i bardhë kur djathi është prodhuar me bazë qumështi delje ose dhie dhe ngjyrë kremi kur djathi është prodhuar nga qumështi i lopës).

Pamja e jashtme të jetë konforme, në brendësi poroze karakteristike e djathit të stazhionuar mirë. Sasia e kripës të jetë normale sipas standartit. Shija të jetë e mirë karakteristike e djathit

normal pa erëra të tjera jo të këndshme.Përmbajtja mikrobiale të jetë sipas normave të miratuara nga Ministria e Shëndetsisë.Treguesit fiziko-kimikë të jenë sipas STASH 1410-87.

Ambalazhimi të jetë në fuçi ose voza deri në 50 kg i shoqëruar me shëllirë, mbi të cilën vendoset etiketa ku të jetë shënuar: lloji i djathit sipas sdandartit në fuçi, origjina e prodhimit të mallit, masa bruto ose neto dhe data e prodhimit.Malli të jetë i shoqëruar me certifikatë të cilësisë për çdo parti prodhimi.

2. Gjalp i freskët per gatim dhe lyerje buke - Bazuar ne STAZH 1445\87

Pamja te jete e njëtrajtshme, pa shtresa, në prerje e sipërfaqe të shënditura pa pika uji dhe mbeturina dhalli.*Ngjyra:* Krem deri në të verdhë të çelur.*Era dhe shija:* E këndshme, karakteristike e gjalpit të freskët pa erë dhe shije të huaj.Treguesit kimik:Lageshtira në % ,jo me shumë se 17.Lëndët e thatë pa yndyr në e %, jo më shumë se 2.Yndyra në %, jo më pak se 81 gjalpi i freskët dhe 79 gjalpi i kripur.Kripë në %, jo më shumë se 2 gjalpi i kripur.Ngarkesa mikrobike brenda normave të lejuara nga Ministria e Shendetesise.

Ambalazhimi:Ambalazhohet në kuti kartoni të valëzuar me masë 1- 5 kg, të veshur nga brenda me letër pergamen.Mbi çdo ambalazh me gjalpë vendoset etiketa në të cilën shënohen:Emërtimi i prodhuesit,Emri i produktit,Pesha neto ose vëllimi i produktit,Data e prodhimit,Kushtet e veçanta të ruajtjes.Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë.këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në menyrë që të mos shpëputet nga ambalazhi.Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mire, të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret nje etiketë shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me një tjetër shënimet e detyrueshme duhet të jene pikë për pikë si të etiketës orgjinale.

Malli të shoqërohet me fletë analize laboratorike, certifikatë orgjine.

Ruajtja dhe transportimi:Gjalpi ruhet në frigorifer në temperaturë 2-4 0C,

3.Qumësht i pasterizuar.

Qumështi të jetë i njëllajtë, pa konservues dhe lëndë të tjera të huaja. Të ketë ngjyrë të bardhë me nuancë të lehtë të verdhë. Të ketë aromë specifike të llojit të qumështit, pa shije dhe erë të huaj. Treguesit fiziko-kimikë, etiketimi, ambalazhimi dhe transportimi i mallit të jenë sipas STASH 1563-1987 dhe Ligjit nr. 9441, datë 11.11.2015 “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi”.

Prodhimi të jetë i shoqëruar me çertifikatë të analizës.

4.Kos

Ai duhet të jetë zënë me qumësht që të përmbushi karakteristikat e mësipërme dhe të jetë i ambalazhuar në gota plastike ose shishe 1 (nje) litershe në të cilat të tregohet firma prodhuese dhe afati I skadencës.Data e skadimit ose afati i përdorimit do të jetë jo më pak se 10 muaj nga data e prodhimit dhe e furnizimit në institucion.

5.Djathe i skremuar (bebe)

Djathe i skremuar me perberje me yndyre shtazore. Djathi te jete i paketuar me pako ne peshe 140 gr dhe te perbehet nga 8 porcione.

❖ Lloji i mallit: Vezë

1.Vezë

Sipas Rregullores nr.1 datë 25.05.2005 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe në zbatim të rregullores CEE Nr. 1907/90 të Këshillit për normat e tregtimit për vezët.

Të jenë me peshë 63 deri 73 gr për /kokërr.

Të jenë të pastra, të thata, pa aroma të pakënshme, të mbrojtura efektivisht nga tronditjet dhe nga kontakti i drejtpërdrejtë me diellin, sipas kërkesave specifike të higjenës bazuar në Udhëzimin Nr. 21 datë 25.11.2010 të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Të jenë të vendosura në bikurina, të ambalazhuara në kuti kartoni ose arka. Shenjat për numrin e dallueshëm të prodhuesit, datës së skadencës të jenë mbi vezë ose mbi ambalazhin e tyre, ose mbi të dyja, ose në vende të dukshme të tyre sipas rregullores së sipërpërmendur.

Transporti i artikujve deri në magazinat përkatëse të Bashkise Kruje do të përballohet me mjetet e subjektit që do të shpallet fitues i tenderit.

Lloji i mallit : Patate ,Qepe, Karrota, Portokalle, Molle dhe Zarzavate te stines

Specifikimet teknike

- **Patate**

Kërkohet cilësia e parë, të jetë e plotë, të forta, të pastra e të thata, jo jeshile, jo të mbira me ngjyrë dhe me sytha tipike të kultivarit.Kokrra të jetë e pjekur.

Madhësia e kokrrës për të rrumbullaktat të jetë për pataten dimërore mbi 5 cm dhe për ato verore mbi 4 cm, për vezaket për dimëroret dhe veroret 4 cm.

Nuk lejohen të çara e të prera, të kalbura, njolla boje hiri e ndryshku, dëmtime nga dosa dhe të papastruara nga dherat.

Treguesit cilësorë sipas STASH 1729-88.

Duhet të jenë të ambalazhuara në thasë rrjete 25 deri ne 30 kg.

- **Qepe**

Kërkohet cilësia e parë, të jetë me pjekuri të plotë, me cipë e bisht të thatë, të shëndosha e të plota, me ngjyrë e forme tipike të kultivarit dhe me gjatësi të bishtit deri në 7 cm.

Madhesia e kokrrës për ovalet të jetë nga 4 deri në 5 cm.

Lejohen jo më shumë se 1 % e partisë me dëmtime të lehta dhe 1 % lëndë të huaja.

Me sëmundje nuk lejohen.

Të ngrira, të kalbura e të mykura nuk lejohen.

- **Karrota.**

Kërkohet e cilësisë së parë të padeformuara dhe me ngjyrën karakteristike të kultivarit. Gjatësia jo më pak se 10 cm, nuk lejohen kalbëzime, ndryshk nuk duhet të ketë njolla me ngjyrë jeshile pasi janë shkaktare të aciditetit dhe sëmundjeve.

Të thata dhe të zverdhura nuk lejohen.

Treguesit cilësorë sipas STASH 1712-88.

- **Molla :**

Kërkohet cilësia e parë, me formë, ngjyrë e shije të kultivarit, pa deformime, me pjekuri teknike të njëjtë, të shëndosha, të pastra, të zhvilluara normalisht, pa erë e shije të huaja. Lejohen edhe kokrra pa bisht, por pa defekte rreth bishtit.

Dëmtime të ndryshme mekanike lejohen deri në dy njolla jo të zeza, të vogla, të lehta për kokërr. Nuk lejohen të kimbura. Njolla të shkaktuara nga dielli në lëkurë nuk lejohen. Gunga në lëkurë nuk lejohen. Njolla nga solucionet kimike në sipërfaqen e kokrrës nuk lejohen më tepër se deri në ¼ e sipërfaqes së frutit.

- **Portokalli :**

Kërkohet cilësi e parë, i freskët, me zhvillim normal, të shëndoshë e me bisht. Pas 15 janarit lejohet kokrra pa bisht, përkatësisht 5 & 20 %, me pjekuri teknike të plotë.

Ngjyra të jetë karakteristike e kultivarit, e verdhë në portokalli, me erë karakteristike dhe shije të ëmbël, pa shije të hidhur. Dëmtime mekanike nuk lejohen. Të prekura nga sëmundjet dhe insektet nuk lejohen. Lëndë të huaja nuk lejohen. Zbutje të kokrrave, ngrirje dhe lagje të sipërfaqes nuk lejohen. Ambalazhimi të jetë me kuti kartoni në brendësi të mbështjelle me letër celofoni standarte 10, 20 ose 30 kg.

Në etiketë të jetë shënuar data e prodhimit dhe data e skadencës si dhe origjina e prodhimit të mallit.

- **Zarzavate te stines**

Kërkohet cilësi e parë, të freskët në varesi të stines

Specifikimet teknike

1.Oriz:

Treguesit shqisorë:*1.Pamja e jashtme:*

Kokrra të shëndosha, të pastëra, të zhveshura tërësisht nga lëvozhga e orizit, pa shije, pa shënja myku ose prishje.

*2.Ngjyra:*E bardhë, lejohen kokrra me nuancë ngjyrë të verdhë.

*3.Era dhe shija:*Karakteristikë e orizit të shëndoshë pa shije të thartë, të hidhur, pa erë myku dhe erë tjetër të huaj.

Treguesit kimik:Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

Amballazhimi:Të jetë me pako prej letre 1 kg neto. Në amballazhin të jetë shënuar edhe afati i skadencës.

2.Makarona - Supe

Treguesit shqisorë:

*1.Forma:*Makarona spageti, me gjatësi 25-30 cm, me diametër 2-2.5 mm.

*2.Pamja e jashtme:*Në formë të rregullt, të plota, me sipërfaqe të lëmuar deri lehtësisht të ashpër. Mbas zierjesmakaronat të jenë elastike, të mos qulloren, të mos çahen dhe të mos krijojnë shkumë.

*3.Ngjyra:*E bardhë me nuancë të verdhë, në thyerje paraqiten qelqore në jo më pak se gjysma e sipërfaqes së seksionit.

4.Era dhe shija: E mirë, karakteristike e makaronave, pa shije të hidhur, të thartë, të mykur dhe për çfarëdo ere dheshije tjetër të huaj.

Treguesit kimik:Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

Amballazhimi:Në qese telefoni me masën 500 gr, këto të futen në kuti kartoni deri 12 kg. Në amballazhin 500 gr të jetë shënuar dhe afati i skadencës jo më pak se 1.5 vjet.

3.Miell Gruri

Treguesit shqisorë:

1.Pamja: Të jetë pluhur i njëtrajtshëm pa lëndë të huaja Insekte dhe dëmtues të tjerë nuk lejohen.

2.Ngjyra: E bardhë

*3.Era dhe shija:*E këndshme, karakteristike e miellit të grurit, pa erë dhe shije të huaj.

Treguesit kimik:Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

Të jetë i cilësisë së parë, i stazhionuar, i amballazhuar në pako 1 kg letre, me etiketë prodhuesi dhe afat skadence të shënuar.Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së

cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë. Këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

4.Vaj Lule Dielli i Rafinuar

Treguesit shqisorë:*1.Pamja:*

Lëng vajor, i artë, pa depozitime.*2.Ngjyra:*

E verdhë, e lehtë.*3.Era dhe shija:*E mirë, karakteristike e vajit të lulediellit të rafinuar, pa shije dhe erë të huaj.

Treguesit kimik:Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

Ambalazhimi dhe etiketimi:Vaj luledielli i rafinuar do të ambalazhohet në shishe plastike me vëllim 1 litërshe, të mbyllur metapë plastike me vidhëzim hermetike të kapsuluara me shirit PVC me stampën përkatëse.Mbi çdo shishe do të vendoset etiketa në të cilën të shënohet:- Emërtimi i plotë i mallit.- Data e skadimit ose afati i përdorimit që do të jetë 18 muaj nga data e prodhimit dhe e furnizimit në institucion.

5.Vaj Ulliri

Treguesit shqisorë:*1.Pamja:*

Lëng vajor, pa depozitime.*2.Ngjyra:*

Në ngjyrë ulliri, e lehtë.*3.Era dhe shija:*E mirë, karakteristike e ullirit, pa shije dhe erë të huaj.

Treguesit kimik:Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

Ambalazhimi dhe etiketimi:Vaj i ullirit do të ambalazhohet në shishe plastike ose qelqi me vëllim 1 litërshe, të mbyllur me

tapë plastike me vidhëzim hermetike të kapsuluara me shirit PVC me stampën përkatëse.

Mbi çdo shishe do të vendoset etiketa në të cilën të shënohet:- Emërtimi i plotë i mallit.

- Data e skadimit ose afati i përdorimit që do të jetë 18 muaj nga data e prodhimit dhe e furnizimit në institucion.

6.Fasule

Treguesit shqisorë

1.**Pamja e jashtme:** Kokrra të plota, të shëndosha,me formë dhe madhësi sipas llojit (ovale , e rumbullakët, e gjatë etj).

2.**Ngjyra:** e bardhë.

3.**Era dhe shija:** Pa erë myku dhe cfarëdo ere tjetër të huaj. Pas zierjes të ketë erë të këndshme, pa shije të hidhur ose cfarëdo ere tjetër të huaj.

Treguesit fiziko – kimikë.

Sipas Standartit Shtetëror 1723-87.

- Lageshtia jo më shumë se 15%.
- Lëndë të huaja jo më shumë se 0.8%.
- Kokrra të thyera jo më shumë se 13%.
- Perzierje kokrrash jo më shumë se 2.2%.

-
- Dëmtime mekanike ose dëmtime nga insektet nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe Etiketimi. Të jetë me thasë 25-50 kg neto. Thasët të jenë të pastër pa lëndë të huaja dhe të thatë. Mbi çdo thes ngjitet etiketa ku shënohet: data e prodhimit, masa bruto ose neto. Afati i skadencës të jetë jo më pak se 1,5 vjet nga data e furnizimit në institucion. Mjeti që e transporton duhet të jetë i mbyllur dhe i caktuar vetëm për produkte ushqimore

7. Sheqer

Treguesit shqisorë.

1. **Pamja e jashtme:** Pluhur i përbërë nga kristale të imta dhe të njëjta, pa lëndë të huaja, i derdhur, i thatë në të prekur dhe të mos ngjitet.
2. **Ngjyra:** e bardhë dhe me shkëlqim.
3. **Shija dhe era:** Shije e ëmbël, pa shije dhe erë të huaj kur është kristal dhe kur tretet në ujë të pastër.
4. **Tretshmëria:** Të tretet plotësisht në ujë, tretësira e tejdukshme dhe pa ngjyrë.

Treguesit fiziko – kimikë.

Sipas Standartit Shtetëror 1413-87.

- Sheqer i pastër i llogaritur me lëndë absolutisht të thata jo më pak se 99,6%.
- Lëndë reduktuese (sheqer invert) jo më shumë se 0,1%.
- Lagështia jo më shumë se 0,16%.
- Hiri jo më shumë se 0,07%.

Ambalazhimi dhe Etiketimi.

Të jetë me thasë 50 kg neto. Thasët të jenë të pastër pa lëndë të huaja dhe të thatë. Mbi çdo thes ngjitet etiketa ku shënohet: data e prodhimit, masa bruto e neto.

Afati i skadencës të jetë jo më pak se 1,5 vjet nga data e furnizimit në institucion

8. Kripe ushqimore

Të jetë e cilësisë së parë, e ambalazhuar në pako 0.5 deri 1 kg.

Pamja: masë kokrrizore me ngjyrë të bardhë.

Me shije karakteristike të kripur, pa shije dhe erë të huaj, e tretshme plotësisht në ujë.

Në ambalazh vendoset etiketa ku shënohet lloji i kripës, origjina e mallit.

Ruhet në vende të pastra dhe të mbrojtura nga lagështira e lëndët kimike.

Për të gjithë artikujt ushqimorë do të zbatohen dispozitat e përgjithshme të Ligjit për Ushqimin Nr. 9863 datë 28.1.2008.

9.Salce Domatesh

Kërkohet salcë domate e amballazhuar në kuti llamarine ose shishe qelqi.

Kutia të jetë e mbyllur hermetikisht dhe e mbështjellë me etiketë të përkthyer në gjuhën shqipe kur malli është i huaj.Përmbajtja të jetë salcë dhe kripë.**Përbërja e lëndës së thatë të jetë 20 % ± 1.**Nuk lejohen përbërës të tjerë dhe lëndë të huaja.Ngjyra e salcës të jetë e kuqe e thellë.

Shija të jetë karakteristike e salcës së domates pa shume aciditet.

Aroma të jetë e këndshme në përputhje me aromën e domates së freskët karakteristike e llojit.

Në etiketë të jetë shënuar qartë firma prodhuese, data e prodhimit dhe përdorimit.

Treguesit fiziko-kimikë dhe ambalazhimi të jenë sipas STASH 1429-87.

10.Niseshte

Të jetë e cilësisë së parë, e stazhionuar, e amballazhuar në pako 1 kg letre, ku të shënohet:Emërtimi i prodhuesit ,Emri i produktit ,Pesha neto ose vëllimi i produktit

Data e prodhimit,Data e skadimit,Kushtet e veçanta të ruajtjes

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë. Këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

11. Cokokrem:

Treguesit shqisore Pamja e jashtme Paketim plastik,ngjyre karakteristike kafe edhe shije te embel , pa erera te pakendeshmeTreguesit Kimik: Sipas standartit shteteror Shqiptar Ambalazhimi 0.5 ose 1kg. Ne kuti te jete shenuar dhe afati I skadences.

12.SodeBuke:

Treguesit shqisorePamja e jashtme Ne gjendje pluhuri I bardhe me shije te athet dhe pa aroma te pakendeshmeTreguesit kimik: Sipas standartit shteteror Shqiptar Paketimi: Me qese telefoni 200g,ku te jete shenuar dhe data e skadences

13.Leng limoni

Treguesit shqisorePamja e jashtmeLeng pa ngjyre me shije te tharte dhe aromen karakteristike te limonitPaketimi me shishe plastike 500g ku te jete shenuar dhe afati I skadences.

14.Kanelle

Treguesit shqisorePamja e jashtme Erez ekzotike me ngjyre kafe ne forme pluhuri ose copa te vogla dhe arome karakteristike te vecanteTreguesit kimik: Ne perputhje me standartin shteteror Shqiptar Paketimi me qese telefoni 100g ku te jete shenuar dhe afati I skadences

15.Vanilja

Treguesit shqisore Pamja e jashtmePluhuri I bardhe ne te verdhe me shijen e saje karakteristike Treguesit kimik : ne perputhje me standartin shteteror ShqiptarPaketimi me qese telefoni 100g ku te jete shenuar afati I skadences

16.Biskota

Treguesit shqisore Pamja e jashtme Biskota me forme te rumbullaket ose katrore me diameter 2.5-3 cm , me siperfaqe abrazive.Ngjyra e biskotave varion ne kafe te hapur dhe te verdhe Aroma varion nga ato me vanilje si dhe aroma te tjera duke eleminuar aromat e pakendeshme dhe aromat e mykjes.Treguesit kimike : Ne perputhje me standartin shteteror Shqiptar Paketimi: Me qese telefoni te mases 2 kg ose me kuti kartoni te mases 12 kg .Ne qese 2 kg te jete shenuar dhe afati I skadences.

17.Peta byreku te thata. Me miell gruri , te fresketa ,te konservuara sipas standartit ushqimor

Shenim:Furnizimi i mallit do te kryhet ne menyre periodike me kerkese te AK , per gjate gjithë periudhes se vlefshmeris se kontrates deri ne ezaurimin e sasise se kontraktuar dhe do dorezohet ne vendet e percaktuara nga ana e AK Bashkia Kruje.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

LOTI II-TË : ‘BLERJE USHQIME ME ORIGJINE SHTAZORE ’

➤ **Lloji i mallit :** Mish viçi i freskët

Kërkohet mish viçi në rritje me cilësi që të plotësojë kërkesat e standartit shtetëror Nr 1441, te vitit 1987.

Pamja e jashtme :

- Sipërfaqja e jashtme të jetë e mbuluar me një cipë të hollë tharje.
- Sipërfaqja e mishit të fthohur menjëhere pas prerjes të jetë i tejdukshëm.
- Tendinat të jenë të ndritshme, elastike dhe të forta.

Ngjyra : Mishi të jetë me ngjyrë rozë dhe i dhjamit të jetë me ngjyrë të bardhë.

Konsistenca : Të jetë e butë dhe elastike. Në prerje të duket kompakt.

Era : Të jetë e këndshme, karakteristike e llojit.

Palca e kockave : Të mbushi të gjithë kanalën e palcës, ngjyra të jetë rozë në të verdhë. Mishi përbëhet nga pjesa e përparme dhe pjesa e prapme proporcionalisht. Koka, mëlçia e zezë, e bardhë, këmbët si dhe të përbrendshmet nuk futen në përbërje të mishit.

Çdo pjesë anatomike të jetë e vulosur me vulën e kontrollit veterinar.Vula duhet te vendoset tek dy kofshet , dy shpatullat dhe dy anet e brinjëve

Çdo parti mishi shoqërohet me çertifikatën veterinare me të cilën vërtetohet se nga kontrolli i kryer nuk është prekur nga sëmundje por që është i sigurt dhe se lejohet të tregtohet për konsum publik.

Çdo parti furnizimi të jetë e ndarë në katër pjesë. Çdo parti mishi shoqërohet me çertifikatë veterinare. Vula e raporti veterinar të jenë të lexueshme mirë. Tregëtimi i mishit të freskët bëhet jo më parë se 6 orë nga koha e therjes në verë, ndërsa në dimër 12 orë.

Transporti i mishit do të bëhet me mjetet e subjektit fitues të tenderit , i përshtatshëm për transport mishi.

Subjekti nese shpallet fitues do te duhet te kete ne stafin e vet numrin e kerkuar te punonjesve ne kriteret kualifikuese, pergjate gjithe kohes se zbatimit te kontrates.

➤ **Lloji i mallit : Mish i Grire Viçi**

-të jete mish vici , në përputhje më standartet shtetërore.

Amballazhimi:

Të jenë të vendosura në qese plasmasi, dhe në kushte sa më higjenike.

Transporti i mishit:

Bëhet me mjete të mbyllura të pastra e të dezinfektuara posaçërisht për mishin (mjet frigoriferik).

Shenim:Furnizimi i mallit do te kryhet ne menyre periodike me kerkese te AK , per gjate gjithe periudhes se vlefshmeris se kontrates deri ne ezaurimin e sasise se kontraktuar dhe do dorezohet ne vendet e percaktuara nga ana e AK Bashkia Kruje.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

LOTI NR 1- Blerje ushqime me origjine jo shtazore

Nr	EMERTIMI I MALLRAVE	NJESIA	SASIA	AFATI LEVRIMIT
1	Buke e bardhe me feta 900 g	cope	1975	12 Muaj nga nenshkrimin e kontrates, Me kerkese te AK deri ne ezaurim te sasise se planifikuar
2	Makarona supe	kg	1500	
3	Oriz	kg	1300	
4	Miell	kg	300	
5	Peta byreku te thata	pako	50	
6	Vaj gatimi	liter	450	
7	Vaj ulliri	liter	200	
8	Fasule	kg	500	
9	Sheqer	kg	450	
10	Kripe	kg	200	
11	Cokokrem	cope	450	
12	Sode buke	kg	10	
13	Salc	shishe	400	
14	Leng limoni	shishe	150	
15	Kanelle	pako(1kg)	50	
16	Biskota	kg	250	
17	Niseshte	pako(250g)	180	
18	Vanilje	pako(100g)	50	
19	Patate	kg	2000	
20	Qepe	kg	600	
21	Karrota	kg	300	
22	Portokalle	kg	300	
23	Molle	kg	900	
24	Zarzavate te stines	kg	100	

Shenim:Mbyllet me nr rendor 24

LOTI II-TË : ‘BLERJE USHQIME ME ORIGJINE SHTAZORE ’

Nr	EMERTIMI I MALLRAVE	NJESIA	SASIA	AFATI LEVRIMIT
1	Qumesht	liter	5000	12 Muaj nga nenshkrimet i kontrates, Me kerkese te AK deri ne ezaurim te sasise se planifikuar
2	Kos	liter	600	
3	Gjalp	kg	336	
4	Veze	cope	12000	
5	Mish vici	kg	500	
6	Mish i grire (Vici)	kg	200	
7	Djathe i skremuar (BEBE)	pako	2000	
8	Djath i bardhe	kg	100	

Shenim :Mbyllet me nr rendor 8

AFATET E LËVRIMIT:

LOTI NR 1- Blerje ushqime me origjine jo shtazore

Nr	EMERTIMI I MALLRAVE	NJESIA	SASIA	AFATI LEVRIMIT
1	Buke e bardhe me feta 900 g	cope	1975	12 Muaj nga nenshkrimet i kontrates, Me kerkese te AK deri ne ezaurim te sasise se planifikuar
2	Makarona supe	kg	1500	
3	Oriz	kg	1300	
4	Miell	kg	300	
5	Peta byreku te thata	pako	50	
6	Vaj gatimi	liter	450	
7	Vaj ulliri	liter	200	
8	Fasule	kg	500	
9	Sheqer	kg	450	
10	Kripe	kg	200	
11	Cokokrem	cope	450	
12	Sode buke	kg	10	
13	Salc	shishe	400	
14	Leng limoni	shishe	150	
15	Kanelle	pako(1kg)	50	
16	Biskota	kg	250	
17	Niseshte	pako(250g)	180	
18	Vanilje	pako(100g)	50	

19	Patate	kg	2000
20	Qepe	kg	600
21	Karrota	kg	300
22	Portokalle	kg	300
23	Molle	kg	900
24	Zarzavate te stines	kg	100

Shenim:Mbyllet me nr rendor 24

LOTI II-TË : ‘BLERJE USHQIME ME ORIGJINE SHTAZORE ’

Nr	EMERTIMI I MALLRAVE	NJESIA	SASIA	AFATI LEVRIMIT
1	Qumesht	liter	5000	12 Muaj nga nenshkrimet i kontrates, Me kerkese te AK deri ne ezaurim te sasise se planifikuar
2	Kos	liter	600	
3	Gjalp	kg	336	
4	Veze	cope	12000	
5	Mish vici	kg	500	
6	Mish i grire (Vici)	kg	200	
7	Djathe i skremuar (BEBE)	pako	2000	
8	Djath i bardhe	kg	100	

Shenim :Mbyllet me nr rendor 8

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Shenim: Kriteret e Përgjithshme janë ekuivalente për të dy lotet respektive

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

LOTI I-RË :“BLERJE USHQIME ME ORIGJINE JO SHTAZORE ‘

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (Ne masen prej 2% të fondit limit të kontrates-lotit të pare)*

1-a)Operatori ekonomik nuk duhet të ketë detyrime të taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe ato të vitit 2023 të njohura nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka selinë në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatorëve duhet të ketë vërtetimin e shlyerjes së taksës vendore 2023 për secilin operator)*

Shenim-Per të përmbushur këto kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 , ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më poshtë :

-
- Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2023 te leshuar nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline sipas QKB, ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se taksës vendore 2023 per secilin operator).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Krujë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

Shenim- Per te permbushur kete kriter, **(piken 2.1.c)** ne fazen e ofertimit eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më siper referuar

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1 Per te provuar permbushjen kriterëve ekonomike e financiare operatori ekonomik duhet te plotesoje kerkesat minimale si me poshte duke dorezuar :

a)-Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8). duke e plotesuar bashkëlidhur me nje deklarate Referuar Ligji 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” , Operatori ekonomik duhet te kete të regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi; operatori ekonomik duhet te kete përmbushur detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni për pagat; operatori ekonomik nuk duhet te kete asnje anëtar te një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, i operatorit ekonomik, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij; te dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale.

2.2.a-Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklarimit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet financiare (2021’2022’2023) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres e fondit limit te kontrates/ lotit nr.1(për secilin prej loteve/ shumatores së loteve për të cilat konkurron”).

Shenim-Pika 2.2-a) plotesohet duke paraqitur vertetimin perkates te Administrates Tatimore .

2.3-Kapaciteti teknik:

2.3-1.a)Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës **me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës/lotit (për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron)**, që prokurohet .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a)-për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
b)-për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira njësi tregtare të përshtatshme në të cilin tregton dhe magazinon mallin që është objekt i këtij loti nr 1, për të cilin duhet të paraqesë :

- Aktin e pronësisë (te vlefshme sipas legjislacionit në fuqi për rregjistrimin e pasurive të paluajtshme), ose Kontratën e marrjes me qira të objektit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së objektit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qerasë të jetë noteriale. (te vlefshme për gjatë gjithë periudhës së parashikuar në afatin e levrimit të mallit) .
- Lejen higjieno-sanitare të objektit të vlefshme (aktin e miratimit higjienosanitar të vlefshëm) të lëshuar nga organet kompetente të Ministrisë së Shëndetësisë në rrethet përkatëse (Inspektoriat që mbulon fushën e shëndetit).
- Certifikatën e dizifektimit për ambientin përkatës të vlefshme.

Shenim- Për të përmbushur këto kriter, në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8, ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më sipër referuar

2.3.3-a)Kandidati/ofertuesi duhet të ketë kryer raport analizen përkatëse për produktet e lotit nr.1 sipas listës së preventivit, pranë laboratoreve të certifikuar sipas kërkesave të nenit 44 e vijues të Ligjit Nr 9863 datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” dhe urdhrit nr 24 datë 30.01.2013 të Ministrisë së Bujqësisë Ushqimit dhe Konsumatorit. Raport analiza laboratorike përkatëse, duhet të jetë lëshuar të pakten tre muaj para datës së dorëzimit të ofertave. Për të provuar piken e mesipërme operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentin përkatës provues.

b)Kandidati /Ofertuesi duhet të paraqesë akt-kontrollin përkatës të kryer nga AKU (te fundit), që vërteton përmbushjen e kërkesave tekniko teknologjike, higjieno-sanitare, fitosanitare dhe veterinarë, verifikimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin dhe licencimin e operatorëve të biznesit ushqimor, si dhe

vetedeklarim nga ana e administratorit te shoqerise ofertuese se nga kontrolli i fundit i kryer nga ana e autoriteti kompetent per sigurine ushqimore aktiviteti permbush kerkesat ligjore respektive.

Shenim- Per te permbushur kete kriter , ne fazen e ofertimit eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më siper referuar

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë te paktën një automjet te pershtatshem transporti (ATP) jofrigorifer, për transportin e mallit objekt prokurimi te lotit nr 1, për të cilin duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm:

- Aktin e pronësisë së mjetit përkatës ose Kontratën e marrjes me qera të mjetit, sipas kushteve si vijon:
 - a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme pergjate gjithë periudhes se realizimit te kontrates), dhe per mjetet e siguruar me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.
- lejen higjensan perkatese te leshuar nga autoriteti kompetent(te vlefshme).

Shenim- Per te permbushur kete kriter , ne fazen e ofertimit eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më siper referuar

2.3.5-a)Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të marrë përsipër te furnizoje/transportoje dhe te mallrat objekt kontrate, ne vendet e percaktuara nga ana e Bashkisë Krujë me mjetet e tij qe ka ne dispozicion sipas kerkeses se AK deri ne ezaurim te sasise se planifikuar edhe ne rastin e tejkalimit te afatit 12 mujor nga data e nenshkrimit te kontrates , nese ka sasi te pa ezauruar. (Deklarate te leshuar nga Administratori i shoqerise).

Shenim: Ne zbatim te nenit 82.5 te Ligjit nr 162/2020 “Per Prokurimin Publik” dhe te pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : *“Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

¹ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit të operatorit fitues para lidhjes së kontratës, në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

LOTI II-TË: "BLERJE USHQIME ME ORIGJINE SHTAZORE "

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (Në masën prej 2% të fondit limit të kontratës-lotit të II-te)*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1-a) Operatori ekonomik nuk duhet të ketë detyrime të taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe ato të vitit 2023 të njohura nga ana e njesisë vendore ku operatori ekonomik ka selinë në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 " Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së taksës vendore 2023 për secilin operator)*

Shenim- Për të përmbushur këto kritere në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8, ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më poshtë:

- Vertetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe detyrimet vendore për vitin 2023 të lëshuar nga ana e njesisë vendore ku operatori ekonomik ka selinë sipas QKB, në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 " Për

sistemin e taksave vendore'', i ndryshuar. (Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se takses vendore 2023 per secilin operator).

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

a)-Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8).

